

DY DIMENSIONET KU JETËSOHET POEZIA E FATOS ARAPIT

Në fillim të viteve `60, në letërsinë shqipe trokiti një poet i ri, i cili do ta vendoste poezinë në të tjera dimensione poetike. Ky ishte poeti Fatos Arapi, i cili u shqua që me vëllimin e parë “Shtigje poetike” (1962), për stilin e tij të veçantë.

Fatos Arapi lindi në Vlorë, më 19 korrik të vitit 1930. Krijimtaria e tij është e gjerë, si poet e prozator, eseist dhe përkthyes. Ajo ka qenë vazhdimisht e vlerësuar dhe e mirëpritur nga lexuesi dhe kritika letrare. Fatos Arapi është vlerësuar me çmime kombëtare dhe ndërkombëtare, ku mund të përmendim çmimin “Kurora e artë” në vitin 2008, çmim që jepet në manifestimet poetike ndërkombëtare që zhvillohen në Strugë të Maqedonisë së Veriut. Në vitin 2014, është botuar krijimtaria e tij poetike, më e mira ndër vite, në katër vëllime: “Më jepni një emër” (Poezi të zgjedhura 1962-1989); “Në kaq pak Tiranë” (Poezi të zgjedhura 1990-1996); “Urna e vogël” (Poezi të zgjedhura 1997-2003) dhe “Një buzëqeshje e pabesueshme” (Poezi të zgjedhura 2005-2010). Poezia e tij ruan vazhdimësinë e rrugës së çelur që nga vitet `60, por në më shumë se 45 vite rrugëtim ajo është pasuruar dhe lartësuar artistikisht.

Edhe pse ka disa vite që Fatos Arapi nuk është fizikisht midis nesh, thirrja e tij: “*Ruajeni atdheun nga tirani dhe tirania!*”, ushton gjithnjë dhe më e fuqishme. Në një atdhe me tiranë dhe tirani, është e vështirë ta gesh njeriun. Jeta njerëzore në fluturimin e saj ka dy krahë të fuqishëm që e bëjnë atë të mos ndalet edhe në kohët më të vështira dhe këto janë liria dhe dashuria. Dimensioni i lirisë është i lidhur ngushtësisht me atdheun. Një atdhe i lirë, pa tiranë dhe tirani, është produkt i një shoqërie të lirë. Një atdhe nën tirani ia ngushton frymëmarrjen shoqërisë, nuk e lë atë që të jetë e lirë, kurse njeriu përjeton dimensionin e një bote absurde, rrotullohet brenda rrahëve të ferrit në kërkim të një drite në horizontin e ditës që vjen. Le të njihemi me disa nga poezitë e poetit Fatos Arapi të botuara në vitet 1997-2003. Autori brenda dimensionit të tiranisë që ka prodhuar atdheu i tij, sidomos në vitin e trishtë 1997, kërkon të shpëtojë njeriun që

do të jetë shpresa e së nesërmes.

Atdheu i lirë dhe tirania, ku njeriu përjeton dritën dhe errësirën

Në poezinë e Fatos Arapit tema e atdheut gjendet në çdo vëllim poetik. Ato janë jo vetëm të shumta në numër, por edhe më të realizuarat artistikisht. Atdheu shpалoset në përmasën e madhështisë dhe secili ndihet krenar për arritjet dhe kontributin e tij, por edhe në përmasën e dhimbjes që i shkaktohet nga tiranët dhe tirania dhe përsëri gjithsecili ndien përgjegjësinë për atë që i është shkaktuar atdheut nga indiferenca e tij. Poezia e tij, midis viteve 1997-2003, ka në shënjestër tiranët dhe tiraninë, shkaktarët kryesorë të fatkeqësisë së shqiptarëve.

Tirania shkaktari i një fati të trishtë

Poezia “Me frymë tiranësh ndoten fatet e mia” shpreh fare qartë atë që po ndodhte në atë vit të mbrapshtë 1977. “*Vetëm një klithje, - thotë poeti, - dhe shpirti është natë*”.

Një klithje që vinte nga ai që sundonte fatet e Shqipërisë: një tiran, një i pashpirt, një mizor, një vrasës i njeriut dhe i shpirtit njerëzor, një vrasës i ditës së sapo zbardhur. Klithje në çdo kryqëzim rrugësh. Dhe poeti pyet: “*Nga të shkoj*”? Përgjigjja nuk i vjen nga dita që jetonte. Ajo ishte një ditë pa dritë, një ditë pa shpresë, një ditë që rrokullisej në humnerat e një fati të trishtë. Pyetjes së poetit i përgjigjet një zë nga e shkuara. Një zë që e kishte ndriçuar rrugëtimin njerëzor, kur kishte pasur mote të nxira. Një zë nga një Mot i Madh, në të cilin shqiptarët nuk e kishin humbur drejtpeshimin, kur ishin ndodhur në humnera tiranie. Një porosi e çmuar: “*Ta lemë të qetë të ardhmen*”.¹

Derisa të vinte e nesërmja, fati i poetit dhe i shqiptarëve do të vazhdonte të ndotej me frymë tiranie. Fatos Arapi bën thirrje që njeriu duhet të ndahet nga tiranët, nuk duhet t`ua zgjasë atyre jetën. Është vetë shoqëria që i prodhon dhe i mban ata. Ai iu drejtohet miqve të tij, poetëve, që në asnjë çast nuk duhet të shtrohen në sofrën e tyre:

*“O poet i mjerë!
Nektar pijnë perënditë e fatit,
Por s`ulen kurrë në sofrë,
Ku shkarëzejnë tiranët”.*²

1 Fatos Arapi, “Gloria Victis”, Botimet “Neraida”, Tiranë, 1977, poezia “Me frymë tiranësh ndoten fatet e mia” gjendet edhe te vëllimi poetik “Urna e vogël”, poezi e zgjedhur, Tiranë, 2014, faqe 7.

2 Fatos Arapi, “Vëllezër hamletë”, Botimet “TOENA”, Tiranë, 2001, poezia “O poet i mjerë”, gjendet nëfaqen 118.

Poezia “Nuk mbyllem dot” tregon për rrënimin që pëson qenia njerëzore në kushte të caktuara historike, njeriun e pafuqishëm përpara një realiteti që e ka shkatërruar qenien njerëzore deri në asgjësim. “*Nuk kam fuqi as të trishtëhem*, - thotë poeti. Po cilat janë shkaqet e këtij depresioni kaq të thellë që e tkurrin qenien njerëzore deri në përmasën e mosndijimit?! Çfarë është bota përreth tij? Ku ndodhet poeti bashkë me bashkëkombasit e tij?

Ai udhëton në një anije pa spirancë, mes erërave që fryjnë kundër tyre. Ç` duhet të bëjmë? Nuk ka një mendim të njerëzve të mençur që i dalin në krye kombit në të tilla fatkeqësi?! Është koha e njeriut-peshk. Ata me fjalët e tyre shurdhojnë mjedisin ku qenia njerëzore është tkurrur duke shkuar deri në vetasgjësim. Është koha kur: “*...peshqit llafazanë shurdhojnë qiellin*”. Çfarë duhet bërë? Si ta luftojmë këtë fantazmë që na ka dalë në krye? Me se të luftojmë për ta zhdukur atë dhe njerëzit-fantazmë që e rrethojnë? Të gjitha mjetet kanë dështuar. Atëherë poeti e gjen forcën tek fjala. Tek fjala e mençur që ka qenë çelësi në zgjidhjen e të gjitha situatave të vështira. Një fjalë që mbart brenda një copëz ironie. Të gjithë bashkë mundet ta zhdukim këtë të keqe që na ka pllakosur dhe rrënuar deri në shpërfytyrim të qenies njerëzore. Në këto kushte ironia është arma e vetme:

*“Më jepni ju një copë ironie,
se nuk e gjej dot në veten time,-
Një copëz ironie,
Sa gjysmëz e krahut të zogut,-
të mbrohem nga shirat e verdhë
të predikimeve të apostujve të lajthitur”.*

Ishte viti kur lotët zëvendësonin stinën e shirave. Ishte viti i absurdit kur qenia njerëzore luftonte vetveten. Ç` virus kishte hyrë brenda nesh? Cilët janë shkaktarët e kësaj gjendjeje të rëndë? Përgjigjja na vjen nga brenda absurdit ku ishim zhytur. Poeti i jep përgjigje kësaj gjendjeje me një varg që vret dhe përgjysmon të keqen që kishte lindur brenda qenies sonë:

*“Të gjitha na kanë faj dhe askush,
deshëm të krijohemi në asgjësimin tonë”.*

Kjo gjendje ku ndodheshim kishte fashitur gjithçka që do të mund t`na nxirrte përtej mureve të absurdit që rrethonte jetët tona. Jeta njerëzore ishte kapituar deri në përgjumje. Ishte sflitur shpirti njerëzor:

*“Tani gjithë dritaret e shpirtit,
janë hapur, bymyer dhe kalbur*

Nga shirat e lotëve.³

Një e keqe e madhe kishte pllakosur trojet e Shqipërisë. Një e keqe e madhe kishte ardhur, e keqe që koha e regjistroi si viti i marrëzisë 1997. Njerëzit luftonin me të keqen dhe vetveten. Luftonin për ringritje, për të dalë nga humnera e marrëzisë ku kishte rënë qenia njerëzore dhe atdheu. Poezia “Lavdi humbësve” tregon që në titull se ndodhemi në qerthullin e një absurditeti, sepse lavdia u kushtohet fitimtarëve. Poezia është shkruar në janarin e vitit 1997, kur firmat piramidale kishin çuar në falimentim ekonomik jo vetëm familjet, por edhe vetë ngrehinën shtetërore. Nisur nga ky vit humnerë ku po rrokullisej Shqipëria, autori e shtrin idenë në një segment të gjatë kohor dhe vëren se ne shqiptarët jemi humbësit e mëdhenj:

*“Artin e shkëlqyer të humbjes
ne e kemi ngritur në fat”.*

Fati na ka rezervuar humbjen e radhës. Po pse ndodh kështu me ne shqiptarët? Përse fati na çon vazhdimisht në humbje? Kush është shkaktari? Për të marrë një përgjigje për këto pyetje në kohët mitologjike, individët dhe popujt u drejtoheshin orakujve. Por jemi në kohët moderne dhe arsyeja njerëzore duhet t’i përgjigjet pyetjes se përse ne shqiptarët humbasim, kurse të tjerët nuk e njohin humbjen, por fitojnë. A ka ndonjë fajtor për humbjet tona të njëpasnjëshme? Kush është fajtori?! Aty ku arsyeja njerëzore ngec në kufijtë e së vërtetës, është arti që i kapërcen këta kufij dhe zbulon reflektimet e rreme që gënjejnë mendjen njerëzore. Është arti që e ndriçon mendjen njerëzore në çastet kur ajo nuk arrin tek e vërteta: “*Gabojmë,- thotë poeti,- se ne si popull nuk e njohim pushtetin e errët të smirës, as lakminë akrep të pushtetit*”.⁴

Tiranët janë bërë pjesë e jetës njerëzore. Shpirti njerëzor është varfëruar dhe nuk shikon dot përtej fushëpamjes ku lëvizin ata. Ata janë tragjikët dhe komikët e jetës së njeriut. Sido që të rrotullohesh, pas do të lësh tiranë dhe përpara përsëri tiranë do të gjesh:

*“Përsërit me vete çfarë të thotë kujtesa:
tiranët ishin fati yt,
ndryshe me se do të argëtohej
syri yt i varfër”?*⁵

3 Fatos Arapi, “Gloria Victis”, Botimet “Neraida”, Tiranë, 1977, poezia “Nuk mbyllem dot”, ... faqe 10.

4 Fatos Arapi, “Gloria Victis”, Botimet “Neraida”, Tiranë, 1977, poezia “Lavdi humbësve”, ... faqe 36.

5 Fatos Arapi, “Ah, sikur të isha një përrallë”, Botimet “TOENA”, Tiranë, 2003, poezia “Nuk është

Xixëllonja shprese nën qiellin e tiranisë

Poezia e Fatos Arapit zbulon jetën njerëzore edhe në dimensionin e saj tragjik. Midis të vdekurve që pushojnë në varreza dhe qenies njerëzore të mbledhur skrupull në fatin e vet, qëndron një shpirt gjysmë i vdekur dhe gjysmë i gjallë, nëpërmjet të cilit, nga dimensionin e vdekjes i vjen një pyetje botës së të gjallëve: *“A nisi të mendojë perëndia e shqiptarëve?”* Jeta tiranase rrokulliset në fatin e saj të trishtë. Bota e të gjallëve nuk arrin dot t’i kuptojë shkakuarët e tragjedisë së tyre. Prej atyre që kishin hyrë e kishin dalë prej rrathëve të ferrit mund të merrej a të kuptohej një përgjigje. Kjo përgjigje vjen e realizuar artistikisht si një bashkëbisedim midis jetës dhe vdekjes, midis të gjallit dhe gjysmë të gjallit që i transmeton jetës njerëzore të vërtetën e hidhur. Shpirti që endej në rrugën e varrezave i drejtohet botës së të gjallëve:

-A nisi të mendojë perëndia e shqiptarëve?
-Nuk e di,- i them unë.
-Po ç`janë ata dy diej të zinj që të digjen në duar?
-Regjisorët e mbrapshtë
të tragjedive tona,-
thotë shpirti që askush s`i afrohet.⁶

Poezia “Fati” pasqyron marrëdhëniet e vështira të njeriut me jetën ku ka fare pak gëzime e shaka që tregojnë për një jetë të lumtur. Rrethi i jetës njerëzore mbyllet dhe njeriut i mungojnë të gjitha. Tkurret dimensionin historik dhe njeriu ka mbetur pa të djeshme. As të sotmen nuk di se si ta jetojë. Kërkon të nesërmen por:

“Fati është çelës kopil,
që thyhet në bravë e të mbetet në dorë”.

Përpara një fati të dështuar njeriu duhet ta krijojë vetë hapësirën e rrugëtimit të tij. Ai duhet të luftojë deri sa të arrijë cakun e fundit dhe të kapërcejë vetveten. Atëherë:

“Përpara hapet muaji i prillit
plot të panjohura”.⁷

vështirë të bësh poezi”, faqe 144.

6 Fatos Arapi, “Më duhet një gjysmë ëndrre”, shtëpia botuese “Mësonjtorja e parë”, Tiranë, 1999, poezia “Përçartje në Tiranë”, faqe 57.

7 Fatos Arapi, “Më duhet një gjysmë ëndrre”, shtëpia botuese “Mësonjtorja e parë”, Tiranë, 1999, poezia “Fati” faqe 67.

Poezia "... ai që duhet të jetë" e trajton njeriun ndryshe. Një njeri ndryshe nga ky i përditshmi i jetës njerëzore. Ç' është njeriu i sotëm? Një kafaz ku mbahen të burgosura agimet. Anije që përplasen shkëmbinjtë të fatit. Njeriu i sotëm ka mbetur pa kujtesë, pa të shkuarën e tij, pa të djeshmen. As të sotmen, as veten nuk e njeh mirë. Ky është njeriu i këtij fillim mijëvjeçari të tretë. Veçse e ka një shteg për të dalë nga kjo gjendje. Një statujë e bardhë buzë kësaj rruge të kërkon dorën ta vendosësh mbi të. Shtrije dorën dhe do të shohësh:

"Shpirtrat që s'ishin, ngjallen aty..."

Kjo marrëdhënie e njeriut me botën, rrethohet nga mistere. Mendja e njeriut tenton të kapë fillin e gjërave që lëvizin para syve të tij dhe mundohet t'i përgjigje pyetjeve: Kush jam dhe si duhet të isha? Dhe përgjigja i vjen natyrshëm: "*Je dritë që vjen nga hapësira qiellore, je tingull që vjen nga gjithësia*". Pikërisht drita dhe tingulli nga të cilat përbëhet i kanë shkaktuar dhe plagët më të rënda.

Në qiell fluturon pulëbardha e njeriut, roja e tij besnike. Po edhe asaj vdekja nuk i ndahet. Midis qiellit dhe tokës rron njeriu me dëshirën për ndryshim:

*"Qiellore, vdekja e pulëbardhës sime.
Aty ballin ka pështetur njeriu,
Ai që s'është, që s'ka për të qenë kurrë.
Ai që duhet të jetë".⁸*

Poezia "Përse unë këtu" jep njeriun e kohëve moderne që në rrugëtimin e vet, ndodhet në situata që nuk dëshiron të ndodhej. Ndodhet aty ku krimi i lajné dhëmbët për t'u përballur me një krim tjetër. Njeriu i mirë gënjen veten se do të dalë prej andej. Po si? Gjykatës i kësaj kohe të çmendur është kotësia. Për këtë gjendje ku gjithçka është shterpë, edhe gjithësia ndjen dhimbjen e saj:

*"Kush i ka dëgjuar yjet në muzg
të vajtojnë, si i kam dëgjuar unë?"*

Njeriu i pafaj që gjykohet nga kotësia hyn e del nëpër dhimbjen e yjeve "*si zogun në kafazët e qiellit...*". I janë mohuar të gjitha. Nuk ka të drejtë të hyjë e të dalë në lirinë e vet. Liria e tij ishte kushtëzuar nga dhëmbët e

8 Fatos Arapi, Vëllezër hamletë, Botimet TOENA, Tiranë, 2001, oezia "... ai që duhet të jetë"..., faqe 110.

krimit. Jeta njerëzore zvarritej muzgut të kohës dhe ditët e njeriut bëheshin përherë e më të vogla. Ditë të zymta për njeriun që priste të lindte ndryshe e nesërmja:

*“Vetëm tirani lehte si një qen
dhe koha shterpë
rrente veten se ishte shtatzanë
me Promethej”.*⁹

Në poezinë e Arapit gjen njeriun që e ka braktisur fati. Ç`duhet të bëjmë, kur e keqja na ndjek pas dhe fatkeqësitë ndjekin njëra-tjetrin për t`na mposhtur? Në këtë rast lëre fatin në fatkeqësinë e tij dhe lëviz përpara. Diku është drita e një shprese, ajo të bën thirrje të shkosh përpara, të mos ndalosh deri sa ta prekësh. Bashkë me shpresën, aty është dhe njeriu ku mund të mbështetesh:

*“Ka mbetur pakëz trishtim xixëllonje
të na rrëfejë udhën për te njeriu,
ku nuk është frikë të shpresosh”*¹⁰.

Poezia “Ku është Atdheu” jep raportet që krijojnë poetët me atdheun e tyre. Ata e rikrijojnë atë ashtu siç e duan, ashtu siç duhet të jetë. Po shoqëria njerëzore sillet ndryshe. Disa e zvogëlojnë atdheun deri sa e futin në portofolin e tyre. Për ta atdheu ka vlerë, aq sa është vlera e pronës së tyre. Disa e shesin në pazare të pista. E konvertojnë shitjen e tij në vila jashtë atdheut.

Nga këta të pabesë, poeti Fatos Arapi nuk po e gjen atdheun e vet madhështor e hijerëndë, ashtu siç e kishte ëndërruar. Në kraharor të atdheut poeti kishte futur zemrën e tij. Ashpër i qorton poeti bashkëkohësit e vet:

*“Kaq herë e vratë dhe prapë ua ngjalla:
më njerëzorë se dhimbja,
Më i lirë se liria”.*

Poeti është i shqetësuar se në këtë atdhe të vvarë, duhet shpëtuar njeriu. Njeriut i ishte vvarë e nesërmja, besimi dhe shpresa. Një atdhe i vvarë, është një atdhe pa histori, pa identitet. Në një atdhe pa histori, njeriu

9 Fatos Arapi, “Më duhet një gjysmë ëndrre”, shtëpia botuese “Mësonjëtorja e parë”, Tiranë, 1999, poezia “Përse unë këtu”, ...faqe 71.

10 Fatos Arapi, “Vëllezër hamletë”, Botimet “TOENA”, Tiranë, 2001, poezia “Shpresë”, faqe 106.

lëviz symbyllur në rrjedhat e kohës. Një njeri që lëviz ku ta shpien erërat e ligësisë që vazhdimisht kanë fryrë në kufijtë e atdheut tonë. Ky njeri lëviz pa një pikë orientuese, që e vret të sotmen dhe i mbyll sytë së nesërmes. Ky njeri duhet shpëtuar duke ia kthyer të gjitha që të lartësohet në dinjitetin e vet: duhet t'i rikthehet e djeshmja e mohuar, e sotmja e nëpërkëmbur dhe e nesërmja në vizionin e lirisë. Atdheu dhe njeriu jetojnë së bashku në dimensionin hapësirë dhe kohë. Poetët, brenda këtij dimensionit, kanë rolin e tyre si ndriçues të ëndrrave dhe shpresave, në errësirë janë kandili i shpresave të mëdha. Poeti vazhdimisht pyet e qorton:

*“Ku është atdheu, ai kryeatdheu,
njerëzori i përzishëm,
që në krahun e vet përjetësisht ka lidhur,-
kordele të zezë,-
fatin tragjik të poetëve”.*¹¹

Poetin e shqetëson fakti që tirania me gjithë përpjekjet njerëzore për ta mposhtur përfundimisht atë, ajo përsëri ringrihet dhe godet shoqërinë në të gjithë përmasën e saj njerëzore:

*“Por unë e di:
Ka vetëm një varr për tiranët-liria”!*¹²
Përjetime në dimensionin e dashurisë

Qenia njerëzore zhvillohet e rrethuar nga një univers dashurie që lidhet me jetën dhe punën, me shkencën dhe artet, por mbi të gjitha qëndron dashuria në çift, rezultat i së cilës është familja dhe vetë shoqëria njerëzore. Dashuria për tjetrin është dashuri për veten tënde, është përkujdesja reciproke e dy qenieve njerëzore. Poeti Fatos Arapi realitetin e jetës njerëzore që lidhet me dashurinë e ngriti në realitete estetike me përmasa universale, duke na e dhënë këtë anë të shpirtit njerëzor me një bukuri të pashoqe në letërsinë shqipe dhe më gjerë.

11 Fatos Arapi, “Vëllezër hamletë”, Botimet “TOENA”, Tiranë, 2001, poezia “Ku është Atdheu” ... faqe 124.

12 Fatos Arapi, “Vëllezër hamletë”, Botimet “TOENA”, Tiranë, 2001, poezia “Tungjatjeta poezia ime” ... faqe 107.

Diell, shpresa dhe zhgënjime

Fatos Arapi i ka kënduar dashurisë gjatë gjithë jetës së tij. Nëse në pjesën e parë të jetës së tij kemi një poezi të vrullshme që i shëmbëllen një lëvizjeje të nxituar për të mbërritur sa më shpejt diku, në segmentin fundor të jetës së tij, vargu është i shtruar dhe i qetë, duke i dhënë mundësinë krijuesit që ta vëzhgojë më qartë botën, ta përjetojë atë në këndvështrime që depërtojnë në thellësi të mistereve që rrethojnë jetën njerëzore. Në këtë zbardhje të mjegullnajës misterioze, një vend të veçantë zënë poezitë që i kushtohen dashurisë. Përveç poezive të veçanta për dashurinë, do të gjejmë strofa dhe vargje në poezitë e tjera të këtij vëllimi që i kushtohen dashurisë, e cila vjen si pjesë përbërëse e botës shpirtërore të njeriut, që e ndihmon atë në çastet e vështira të vetmisë apo të një trishtimi e zhgënjimi të thellë nga rrethanat individuale ku përplaset qenia njerëzore. Edhe në një vjershë që nuk i kushtohet dashurisë si “Vëllezër hamletë”, e cila është ndërtuar rreth asaj pyetjes së famshme “të rrosh a të mos rrosh”, pak dashuri e ka bërë poezinë më të ngrohtë e më jetësore:

*“Dy skajet e një kordeleje të përzishme
ecin në ajër, kërkojnë krabun
e një dashurie, ku të lidhet”.¹³*

Njeriut të moshuar, që moshja e detyron të mbyllet në guaskën e vetmisë, i shfaqet një tjetër përmasë njerëzore, ajo e kujtimeve. Lëviz e shkuara dhe njeriu i moshuar shikon se si ka ecur në jetë, ku ka vepruar drejt dhe ku ka gabuar:

*“Një lot më ra në filxhanin e kafesë
kujtimi u shkri, por ti jo.
Në moshën time kafen e pikan të hidhur.
Ardhka vetmia e bëhet Ajo”.¹⁴*

Poezia e Fatos Arapit hap shtigje të reja dhe bëhet pjesë e universit poetik të planetit tonë. Ajo ka përmasa universale dhe ai ecën i sigurt në këtë hapësirë të re ku e çon natyrshëm fuqia e vargut të tij. Kjo hapësirë poetike ku ai ecën, e pa eksploruar më parë, përbën origjinalitetin

13 Fatos Arapi, “Vëllezër hamletë”, Botimet “TOENA”, Tiranë, 2001, poezia “Vëllezër hamletë”, ... faqe 138.

14 Fatos Arapi, “Më duhet një gjysmë ëndrre”, shtëpia botuese “Mësonjëtorja e parë”, Tiranë, 1999, poezia “Ardhka vetmia”, ... faqe 86.

e profilit të tij poetik. Vargu i tij i shëmbëllen një çelësi magjik, me anë të së cilit depërtohet në misteret e botës ku jetojmë. Poezia “Ditë tiranase” është shkruar në vitin e mbrapshtë për shqiptarët, kur shteti u thërrmua dhe individi përjetonte vetminë e tij në një realitet të trazuar nga krismat e armëve dhe vrasjet e njerëzve të pafajshëm. Njeriu përjeton realitete të frikshme, të pajetuara dhe të paimagjinuara më parë. Në këtë realitet, personazhi lirik ndjehet i mposhtur dhe i lodhur, por dalja nga ky realitet vjen përmes figurës së Asaj, që është qenia e dytë brenda një jete njerëzore që mund të jetë bashkëshortja apo dhe Ajo, e larguara në parajsën qiellore. Ajo, qenia njerëzore me fytyrën grua, do të bëjë ndryshimin e madh që njeriu mashkull të vihet përsëri në lëvizje, në rrugëtimin e tij të pandalshëm. Në këtë univers poetik ndjehet çfarë do të ndodhë në momentet që vijnë:

*“E di: zembreku i zemrës sime
është pluhurosur, - kur do të vijë Ajo,
me frymën e saj t'i fryjë,
të ndiej ecjen tingëlluese të kohës”:*

Pasi ka dalë nga gjendja e mëparshme shpirtërore, në pikënisjen e një vrulli të ri, vështrimi vërtitet rreth qiellit të Tiranës. Diçka e re dhe e papritur: një unazë e zjarrtë. Po unaza është për një çift simboli i lidhjes njerëzore në besë dhe në fjalë. Ky simbol i dashurisë i ka prekur të gjithë:

*“Në qiellin e Tiranës, një unazë e zjarrtë
fluturon nga syri në sy –
kërkon gishtin e nuses”.¹⁵*

Në dimensionin misterioz të dashurisë

Në poezinë e Fatos Arapit dashuria merr forma dhe nuanca të panumërta që i mbart një jetë njerëzore. Moskuptimi i njëri-tjetrit në kohën e duhur, vorbullat e acarta të jetës, përgatisin dhe ndarjen që shkon deri në trishtim. Aty, në skajin e trishtimit, dashuria merr formën e saj, por përsëri mbetet e pakapshme, duket dhe zhduket. Dashuria është: *“Dhe trajtë, dhe ndjellje, dhe zhbërje”*.¹⁶

15 Fatos Arapi, “Gloria Victis”, Botimet “Neraida”, Tiranë, 1977, poezia “Ditë tiranase” ...faqe 8.

16 Fatos Arapi, “Më duhet një gjysmë ëndre”, shtëpia botuese “Mësonjëtorja e parë”, Tiranë, 1999, poezia “Do të pendohet marsi që na ndau”, ...faqe 84.

Në këtë udhëtim qenia njerëzore mbart me vete dhe gjysmën e saj, një ecje me shtrëngim duarsh dhe ndarje, një ecje që kalon përmes pikëllimesh dhe tragjedish. Në këtë ecje ai ndjehet bosh, si një sallë e braktisur. Bashkë me të udhëton dhe Ajo, gjersa është shoqja e tij. Një dashuri i ka të përbashkëta gëzimet dhe tragjeditë, çastet e lumtura dhe trishtimin:

*“Midis netësh të borta
kalojmë e s`guxojmë të flasim,
sepse prej zërit tone
mund të këputen orteqet e vdekjes.
Jam me ty, si zemra me rrahjet e saj.
A më kupton, moj zemra ime”?*¹⁷

Te poezia “Jemi takuar e ndarë në një ëndërr”, dashuria për poetin është dhimbje, jo vetëm në jetë, por edhe në ëndërr. Dashuria e mban ndezur qenien njerëzore në çdo moment të frymëmarrjes së tij. “*Ecim,- thotë poeti, - isha unë e ti*”. Në këtë pikë të papërcaktuar në kufijtë e irrealit ecën edhe dikush tjetër, ecin dhe hije të tjera. - *Kujdes!*- e porosit e dashura e tij. *Kujdes!* Jemi në kufijtë e Akerontit. Jemi në kufijtë e jetës e të vdekjes. Në këtë udhëtim të mjegullt, në këtë ecje për diku, drejt një pike të vetme, ku frymonte takimi dhe ndarja, qenia njerëzore i kapërcen kufijtë e ëndrrës dhe kthehet në jetën reale:

*“Jemi takuar e ndarë në një ëndërr,
e paëndërrta ime”.*¹⁸

Dashuria vjen në vargun e Fatos Arapit si dhimbje besnike, por edhe si dhimbje e brishtë, dashuria është mençuri, por edhe pagjumësi. Dashuria ka sy të dhimbshëm dhe shpirt të limontë. Poeti krijon me vargjet e tij atmosferën e një dashurie të shëndetshme. Dashuria dhe tempujt qëndrojnë pranë njëri-tjetrit si dy gjëra të shenjta për njeriun. Dashuria dhe tempujt plotësojnë njëri-tjetrin për të çuar në përsosmëri qenien njerëzore. Por lumturia qëndroka në skajin tjetër, si pikë orientuese drejt së cilës projektohet një udhëtim. Në këtë udhëtim shpesh trishtimi prek zemrat e njerëzve dhe:

*“...çdo çast vetveten krijojmë
prej shkrumbrash trishtimesh”.*¹⁹

17 Fatos Arapi, “Më duhet një gjysmë ëndre”, shtëpia botuese “Mësonjëtorja e parë”, Tiranë, 1999, poezia “Po gjersa ti je shoqja ime”, ... faqe 92.

18 Fatos Arapi, “Ah, sikur të isha një përrallë”, Botimet “TOENA”, Tiranë, 2003, poezia “Jemi takuar e ndarë në një ëndërr”, ... faqe 162.

19 Fatos Arapi, “Ah, sikur të isha një përrallë”, Botimet “TOENA”, Tiranë 2003, poezia “Asgjë, moj

Përfundim

Në poezinë e Fatos Arapit vargu ka një përthyerje origjinale nga pesha e metaforave dhe e figurave të shumta letrare. Frymëzimi poetik derdhet natyrshëm, si një përjetim i thellë i realitetit, si një domosdoshmëri për të plotësuar një boshllëk që ishte krijuar midis individit dhe realitetit që e rrethonte. Mendimi poetik lëviz mbi një territor gjeografik që quhet atdhe dhe njeriut që e kërkon fatin e vet brenda kësaj hapësire. Atdheu në rrjedhën e historisë së tij nuk u ka përkitur popujve përherë, por ka qenë i pushtuar edhe nga tiranët. Nën një pushtet tiranie njeriu përthyer në dinjitetin e vet njerëzor dhe shpesh bëhet bashkëpunëtor i tij. Tek këta njerëz e gjen tirani forcën e vet. Fati njerëzor bëhet gjithnjë e më i vështirë, kur fatin e tij e kanë përcaktuar tiranët. Ndaj thirrja e poetit është se duhet të rrëzojmë tiraninë që atdheu të lartësohet në dinjitetin e vet, të ngrihet në dinjitetin e vendeve dhe kombeve të tjera të botës.

Poezia e Fatos Arapit është ngjizur në një trajtë të përsosur artistike, duke u bërë pjesë e rëndësishme e universit të tij poetik. Atdheu dhe dashuria janë binomi mbi të cilat lartësohet poezia e tij. E dashura, e cila emërtohet shpesh me përemrin “Ajo”, është pjesë e rëndësishme e jetës. Arapi ishte vazhdimisht në kërkim të poezisë. Prurja e tij poetike ka qenë kurdoherë e freskët dhe e papërsëritshme, pasqyrim përgjithësues i fuqishëm i realitetit të kohës në të cilën jetoi. Kjo ndihet edhe në poezitë e tij të dashurisë të shkruara në vitet 1997-2003, ku pasqyrohet tragjizmi i jetës njerëzore, reflektuar në familje, ku ecet në një horizont të zymtë dhe të mjegullt të mbushur me pasiguri, ankth e mosbesim. Në këtë realitet shqiptar të këtyre viteve, ku dëshpërimi dhe pesimizmi janë të pranishëm edhe në marrëdhëniet në çift, realiteti estetik i krijuar në poezinë e dashurisë i shpërthen kornizat kohore të këtyre viteve dhe me nota të fuqishme përgjithësuese krijon shtigje besimi. Brenda çiftit Ai-Ajo, gjallon jeta, dhe lëvizja shkon drejt një të ardhmeje më të sigurt.

Bibliografia

1. Fatos Arapi, “Gloria Victis”, Botimet “Neraida”, Tiranë, 1977.
2. Fatos Arapi, “Më duhet një gjysmë ëndrrë”, shtëpia botuese “Mësonjëtorja e parë”, Tiranë, 1999.
3. Fatos Arapi, “Vëllezër hamletë”, Botimet “*TOENA*”, Tiranë, 2001.
4. Fatos Arapi, “Ah, sikur të isha një përrallë”, Botimet “*TOENA*”, Tiranë, 2003.
5. Fatos Arapi, “Urna e vogël”, poezi e zgjedhur, Botimet “Neraida”, Tiranë, 2014.